

Shoqata e kontabilistëve të certifikuar dhe auditorëve të
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

Kontabiliteti Financiar

P1

Zgjidhjet

FLETË PROVIMI
Exam Paper

Shënim: Emrat e individëve, vendeve dhe kompanive, të përdorura në këtë provim janë fiktive. Çdo ngjashmëri është plotësisht e rastësishme

Data 18.01.2025

Problemi 1

Monika ka biznes individual të qepjes. Ajo ka punësuar motrën e saj Nina për t'i ndihmuar me mbledhjen e parave dhe lëshimin e faturave për klientët që kryejnë pagesa, zakonisht me këste, kur dorëzojnë materialet në dyqanin e Monikës dhe kur marrin rrobat e tyre të përfunduara. Nina është përgjegjëse për regjistrimin e të gjitha arkëtimeve dhe pagesave në librin e arkës së biznesit.

A) Më 30 qershor 2024, libri i arkës i Monikës tregonte një mbitërheqje prej 13,795€, ndërsa llogaria bankare tregonte saldo kreditore prej 655€.

Gjatë hetimeve të kryera, janë zbuluar gabimet e mëposhtme:

- (i) Monika lëshoi çeqe për furnitorët e materialeve me një vlerë totale prej 4,710€ në qershor 2024. Këto u debituan nga llogaria bankare më 7 korrik 2024.
- (ii) Monika tërhoqi para 500€ më 28 qershor, të cilat nuk u regjistruan në librin e arkës.
- (iii) Një prej çeqeve të lëshuara nga Monika për furnitorët e kopseve speciale për kostume figuron në llogarinë bankare si 3,250€, por u regjistrua gabimisht nga Nina si 2,800€.
- (iv) Monika nuk ka bërë ende asnjë regjistrim për urdhrin që i dha bankës për të transferuar 12,500€ nga llogaria e saj personale në llogarinë e biznesit, transferim i cili u krye nga banka më 30 qershor 2024.
- (v) Tarifat bankare prej 645€ u debituan nga banka më 30 qershor 2024, por nuk u regjistruan nga Monika deri në atë datë.
- (vi) Monika kishte lëshuar një çek për një furnitor të makinës zigzag me vlerë 1,380€ më 23 qershor 2024. Më 26 qershor 2024, çeku u refuzua, por Monika nuk e kishte regjistruar këtë deri më 30 qershor.
- (vii) Monika mori çeqe nga klientët e saj më 28 qershor me një vlerë prej 2,285€. Këto nuk pasqyroheshin në llogarinë bankare deri më 3 korrik 2024.
- (viii) Monika mori njoftim me telefon nga banka për një urdhër periodik nga një klient i saj prej 260€. Monika e regjistroi këtë në qershor, por banka nuk e formalizoi hyrjen në fletëllogarinë bankare për shkak të një gabimi.

B) Në përpjekjen e saj për të mbajtur një sistem të kontabilitetit të dyfishtë për biznesin e motrës së saj, Nina, e cila ka njohuri bazike të kontabilitetit, ka bërë gabimet e mëposhtme:

1. Llogaria e blerjeve ishte nënvlerësuar me 600€.
2. Shitja e një automjeti të biznesit për para në dorë 1,500€ ishte regjistruar saktë në llogarinë e arkës, por ishte kredituar në llogarinë e shitjeve.
3. Monika pagoi 300€ për sigurimin e automjetit personal duke përdorur kartën e debitit të biznesit, por Nina e përfshiu këtë shumë në llogarinë e shpenzimeve të automjeteve.
4. Shitjet e mallrave me kredi 800€ ishin plotësisht të pa-regjistruara në librat e kontabilitetit.
5. Një faturë për energji elektrike prej 550€ u regjistrua saktë në llogarinë e energjisë elektrike dhe u debitua në llogarinë e detyrimeve.

Kërkohet:

- (a) Përgatit llogarinë e korigjuar bankare të Monikës më 30 qershor 2024. (7 pikë)
- (b) Përgatit harmonizim të llogarisë së bankës me librin e arkës të korigjuar të Monikës më 30 qershor 2024. (5 pikë)
- (c) Trego hyrjet në ditar për të korigjuar gabimet (1-5) të bëra nga Nina, duke përfshirë përpilimin e llogarise pezull. (8 pikë)

[Total: 20 pikë]

Zgjidhja e problemit 1

A) Libri i arkës i korrigjuar i Monikës deri më 30 qershor 2024

	(Debi) €		(Kredi) €
Kapitali i investuar	12,500	Saldo e pakorrigjuar	13,795
Çeku i kthyer	1,380	Tërheqje	500
		Gabimi (3250-2800)	450
Saldo ne fund	<u>1,510</u>	Tarifat bankare	<u>645</u>
	<u>15,390</u>		<u>15,390</u>
		Saldo e korrigjuar ne fund	1,510

B) Harmonizimi i llogarisë së bankës me librin e arkës të korrigjuar të Monikës deri më 30 qershor 2024

€

Saldo e pakorrigjuar sipas pasqyrës së bankës:	655
Plus: Çeqet që nuk janë kredituar (Depozitat ne tranzit)	2,285
Plus: Arketimi nga klienti i lënë jashtë (Gabimi I bankes)	260
Minus: Çeqet e paparaqitura (pa paguara):	(4,710)
Saldo e korrigjuar sipas harmonizimit bankar:	(1,510)

c)

Hyrjet korrigjuese

		DEBI	KREDI
i)	Blerjet	600	
	Llogaria pezull		600
ii)	Shitjet	1,500	
	Automjeti		1,500
iii)	Tërheqjet	300	
	Shpenzimet e mjeteve motorike		300
iv)	Të arkëtueshmet	800	
	Shitjet		800
v)	Llogaria pezull	1,100	
	Të pagueshmet per energjine elektrike		1,100

Llogaria pezull

Te pagueshmet 1,100 Saldo e pakorrigjuar
500(Saldo bal.)

Blerjet 600
1,100 1,100

Saldo e korrigjuar 0

Problemi 2

Të dhënat e mëposhtme përfaqësojnë pasqyrat financiare të Zana shpk:

Zana shpk Pasqyra e të Ardhurave për vitin e përfunduar më 30 prill 2024

	€'000
Shitjet	426,540
Kosto e shitjeve	<u>(417,950)</u>
Fitimi bruto	8,590
Kostoja e shperndarjes	(230)
Shpenzimet administrative	<u>(3,555)</u>
Fitimi operativ	4,805
Të hyrat nga investimet	35
Shpenzimet e interesit	<u>(670)</u>
Fitimi para tatimit	4,170
Shpenzimet e tatimit	<u>(1,500)</u>
Fitimi neto i vitit	<u>2,670</u>

Zana shpk
Pasqyra e pozicionit financiar

	30 Prill 2024	30 Prill 2023
	€'000	€'000
Pasuritë jo qarkulluese:		
Prona, fabrika dhe pajisjet	3,790	3,120
Pasuritë e paprekshme	2,530	1,100
Investimet	-__	<u>205</u>
	6,320	4,425
Pasuritë qarkulluese		
Stoqet	1,700	1,050
Të arkëtueshmet	3,850	2,170
Paraja e gatshme	215	15
Total pasuritë	<u>12,085</u>	<u>7,660</u>
Ekuiteti dhe detyrimet		
Ekuiteti		
Kapitali aksionar (1€)	2,150	1,150
Premia në aksione	1,750	1,500
Rezerva e Rivlerësimit	1,090	900
Fitimet e mbajtura	<u>2,420</u>	<u>1,620</u>
	7,410	5,170
Detyrimet afatgjatë		
Kredi afatgjatë	2,470	550
Detyrimet afatshkurtëra		
Të pagueshmet ndaj furnitorëve	375	120
Interesi i pagueshëm	580	890
Tatimet	<u>1,250</u>	<u>930</u>
Total Ekuiteti dhe detyrimet	<u>12,085</u>	<u>7,660</u>

Informacione shtesë:

1. Dividenda e zakonshme e paguar u ngarkua në fitimet e mbajtura.
2. Prona me kosto prej 840,000€ dhe vlerë neto ne libra prej 460,000€ u shit për 310,000€. Fitimi ose humbja nga shitja eshte përfshier ne P/ A.
3. Aksionet e zakonshme u emetuan gjatë vitit me vlerën e tyre të drejtë.

4. Ekstrakti i mëposhtëm vjen nga tabela e pasurive jo-qarkulluese:

Data	30 Prill 2024	30 Prill 2023
	€'000	€'000
Prona, fabrika dhe pajisjet:		
Kosto:	7,250	5,890
Zhvleresimi i akumuluar:	<u>(3,460)</u>	<u>(2,770)</u>
Vlera Neto ne libra	<u>3,790</u>	<u>3,120</u>

5. Të ardhurat nga shitja e investimeve afatgjata ishin 245,000€. Fitimi ose humbja nga shitja e këtyre investimeve u përfshi në P/A.

Kërkesa:

(a) Përgatit pasqyrën e rrjedhjes së parasë për Zana shpk për vitin qe perfundon më 30 prill 2024 në përputhje me SNK 7, duke përdorur metodën indirekte. (17 pikë)

(b) Shpjegoni tre (3) avantazhe të kontabilitetit të rrjedhjes së parasë për përdoruesit e ndryshëm të informacioneve financiare. (3 pikë)

[Totali: 20 pikë]

Zgjidhja e problemit 2

Zana SH.P.K.

Pasqyra e rrjedhjes së parasë për vitin që përfundon më 30 Prill 2024

	'000€	'000€
<u>Rrjedhja e parasë nga Aktivitetet Operative</u>		
Fitimi para tatimit	4,170	
Korrigjimet për:		
Kosto financiare	670	
Të ardhurat nga investimet	(35)	
Zhvlerësimi (Llog 10)	1,070	
Humbje nga shitja e pasurive jo-qarkulluese (Llog.1)	150	
Fitimi nga shitja e investimit (Llog.2)	<u>(40)</u>	
	5,985	
Rritja në stoqe (1,700 - 1,050)	(650)	
Rritja në të arkëtueshmet (3,850 - 2,170)	(1,680)	
Rritja në të pagueshmet (375 - 120)	<u>255</u>	
Paraja e gjeneruar nga operacionet	3,910	
Interesi i paguar (Llog.3)	(980)	
Tatimi I paguar (Llog.4)	<u>(1,180)</u>	
Rrjedhja neto e parasë nga aktivitetet operative		1,750
<u>Rrjedhja e parase nga Aktivitetet investuese</u>		
Blerja e pasurisë jo-qarkulluese (Llog.5)	(2010)	
Blerja e pasurive te paprekshme (Llog.6)	(1430)	
Paraja nga shitja e pasurisë jo-qarkulluese	310	
Paraja nga shitja e investimeve afatgjata	245	
Arketimet nga investimi-mund te paraqitet edhe tek A.Operative	35	
Rrjedhja neto e parasë nga aktivitetet investuese		(2,850)
<u>Rrjedhja e parase nga Aktiv. financuese</u>		
Emetimi i aksioneve (Llog.7 dhe 8)	1,250	
Kreditë afatgjata (2,470 - 550)	1,920	
Dividenta e paguar (Llog.9)	<u>(1,870)</u>	
Rrjedhja neto e parase nga aktivitetet financuese		<u>1,300</u>
Rritja neto e parasë dhe ekuivalenteve të saj gjate vitit		200
Paraja dhe ekuivalentet e saj në fillim		<u>15</u>
Paraja dhe ekuivalentet e saj ne fund		<u>215</u>

b)

- Drejtimi i vëmendjes së menaxhmentit në aftësinë e subjektit për të gjeneruar para.
- Një mënyrë më gjithëpërfshirëse për të matur performancën dhe për ta krahasuar me kompani të tjera ose të njëjtën kompani vit pas viti.
- Më e lehtë për t'u kuptuar dhe për t'u audituar.
- Raportimi i rrjedhjes së parasë plotëson më mirë nevojat e të gjithë përdoruesve, pra për marrjen e vendimeve nga menaxhmenti; menaxhimi i besueshmërisë për aksionarët dhe auditorët, si dhe për punonjësit.

-Mbajtja ne kontroll e likuiditetit dhe soventitetit te kompanise

Llogaritjet për a)

1. Humbja nga shitja e Pasurive jo-qarkulluese

Vlera neto ne libra	460,000€
Shitja	<u>310,000€</u>
Humbja	150,000€

2. Fitimi nga shitja e investimeve

Vlera ne libra e investimeve	205,000€
Shitja	<u>245,000€</u>
Fitimi	40,000€

3. Interesi i paguar

Interesi I pagueshëm			
	€'000		€'000
Interesi I paguar (Paraja)	980	Saldo në fillim	890
Saldo në fund	580	Shpenzimet e interesit	670
	<u>1,560</u>		<u>1,560</u>

4. Tatimi I paguar

	€'000		€'000	Tatimi i
Tatimi I paguar	1,180	Saldo ne fillim	930	
Saldo ne fund	1,250	Shpenzimi i tatimit	1,500	
pagueshëm				
	<u>2,430</u>		<u>2,430</u>	

5. Blerja e pasurive jo-qarkulluese

Prona, fabrika dhe pajisjet			
	€'000		€'000
Saldo ne fillim	5,890	Shitja	840
Rivlerësimi	190		
Blerja (Shifer balancuese)	<u>2,010</u>	Saldo në fund	<u>7,250</u>
	<u>8,090</u>		<u>8,090</u>

6. Blerja e pasurive te paprekshme

	'000€
Saldo ne fund	2,530
Minus-Saldo ne fillim	<u>1,100</u>
Blerja.	1,430

7. Emetimi i aksioneve
(2,150-1,150) 1,000€

8. Premia në aksione
(1,750-1,500) 250€

9. Pagesa e dividendës '000€

Fitimet e mbajtura ne fillim	1,620
Fitimi neto i vitit	2,670
Fitimet e mbajtura ne fund	<u>(2,420)</u>
Dividentat e paguar	1,870

10. Shpenzimi I zhvlerësimit

Zhvlerësimi i akumuluar			
	'000€		'000€
		Gjendja ne fillim	2,770
Shitja (840-460)	380		
Gjendja në fund	<u>3,460</u>	Shpenzimi i vitit	<u>1,070</u>
	<u>3,840</u>		<u>3,840</u>

Problemi 3

Që nga fillimi i viteve 2000, tregtia me kredi është bërë normë për shumicën e llojeve të bizneseve për shkak të shumë faktorëve kontribues. Ndër faktorët, kriza ekonomike botërore luan rolin kryesor. Megjithatë, kjo lehtësi nuk është pa rreziqe. Shumë biznese që shesin me kredi përballen me një rrezik të zakonshëm - 'rrezikun e kredisë', që do të thotë pamundësinë e shitësit për të mbledhur para nga klientët me kredi.

Klejdi është një biznes individual dhe furnizon mobilje me kredi për klientët në Kosovë dhe disa të tjerë jashtë Kosovës. Kriteri i tij për kredi është që një klient duhet të njihet personalisht nga ai ose përndryshe ata duhet të blejnë me para në dorë.

Detajet e të hyrave të Klejdit, borxhet e parkëtueshme dhe lejimet për borxhe të dyshimta janë si më poshtë për tre vitet e para të tregtimit të tij:

Viti deri më 30 qershor 2022	(‘€)
Saldo e borxheve të klientëve më 30 qershor 2022	30,000
Borxhi I dyshimte –Borxhi i Semit	5,000
Lejimi i përgjithshëm që do të bëhet prej 2% të arkëtueshmeve të papaguara	
Borxhi i paarkëtueshëm që do të fshihet nga librat për vitin deri më 30 qershor 2022.	2500
Viti deri më 30 qershor 2023	(‘€)
Saldo e borxheve të klientëve më 30 qershor 2023	45,000
Borxhi I dyshimte – borxhi i Musas	1,500
Lejimi i përgjithshëm që do të bëhet prej 3% të arkëtueshmeve të papaguara	
Borxhi i paarkëtueshëm që do të fshihet nga librat për vitin deri më 30 qershor 2023.	2800
Viti deri më 30 qershor 2024	(‘€)
Saldo e borxheve të klientëve më 30 qershor 2024	50,000
Borxhi I dyshimte	0
Lejimi i përgjithshëm që do të bëhet prej 3% të arkëtueshmeve të papaguara	
Borxhi i paarkëtueshëm që do të fshihet nga librat për vitin deri më 30 qershor 2024.	3000

Kërkohet:

Përgatitni regjistrimet relevante për secilin prej tre viteve deri më 30 qershor 2022, 2023 dhe 2024, duke përfshirë ekstrakte nga pasqyra e pozicionit financiar dhe P | A më 30 qershor për secilin prej tre viteve.

(20 pikë)

Zgjidhja e problemit 3

a) Viti 1

DEBI Shpenzimet e borxheve te keqija	2,500
KREDI Llogarite e arketueshme	2,500

Lejimi i pergjithshem= $2\% * (30,000 - 5,000 \text{ lejimi specifik} - 2,500 \text{ borxhi I keq}) = 2\% * 22,500 = 450$

Total lejimet= $450 + 5,000 = 5,450$

Lejimi për të arkëtueshmet	
€	€
	Saldo ne fillim 0
	<u>Shpenzimet e borxheve te dyshimta 5,450</u>
	Saldo ne fund 5,450

DEBI Shpenzimet e borxheve te dyshimta	5,450
KREDI Lejimet	5,450

b) Viti 2

DEBI Shpenzimet e borxheve te keqija	2,800
KREDI Llogarite e arketueshme	2,800

Lejimi i pergjithshem= $3\% * (45,000 - 1,500 \text{ lejimi specifik} - 2,800 \text{ borxhi I keq}) = 3\% * 40,700 = 1,221$

Total lejimet= $1,221 + 1,500 = 2,721$

Lejimi për të arkëtueshmet	
€	€
	Saldo ne fillim <u>5,450</u>
Te hyrat nga borxhet e dyshimta 2,729	

Saldo ne fund 2,721

DEBI Lejimet 2,729

KREDI Te hyrat nga borxhet e dyshimta 2,729

c) Viti 3

DEBI Shpenzimet e borxheve te keqija 3,000

KREDI Llogarite e arketueshme 3,000

Lejimi i pergjithshem= 3%* (50,000- 3,000 borxhi I keq)=3%* 47,000=1,410

Total lejimet=1,410

Lejimi për të arketueshmet			
	€		€
		Saldo ne fillim	<u>2,721</u>
Te hyrat nga borxhet e dyshimta	1,311		
		<u>Saldo ne fund</u>	<u>1,410</u>

DEBI Lejimet 1,311

KREDI Te hyrat nga borxhet e dyshimta 1,311

Ekstrakt nga Pasqyra e te Ardhurave

Vitet	Viti 1	Viti 2	Viti 3
Te hyrat nga borxhet e dyshimta	----	2,729	1,311
Shpenzimet e borxheve te dyshimta	5,450	----	----
Shpenzimet e borxheve te keqija	2,500	2,800	3,000

Ekstrakt nga Pasqyra e pozicionit financiar

Vitet	Viti 1	Viti 2	Viti 3
Llogarite e arketueshme -borxhi I keq	27,500	42,200	47,000
-Lejimet	(5,450)	(2,721)	(1,410)
Ll/A Neto	22,050	39,479	45,590

Problemi 4

Kamelia shpk është firmë e madhe kontraktimi në industrinë minerale me bazë në Kosovë. Bilanci vërtetues i mëposhtëm më 31 dhjetor 2023, është përgatitur nga një praktikant i financave.

	Debi	Kredi
	€	€
Kapitali i aksioneve të zakonshme		60,000
Rezerva e përgjithshme	30,000	
Mjetet motorike - Kostoja	54,000	
- Zhvlerësimi i akumuluar në 1 janar 2023		18,000
Mobilje dhe Pajisje - Kostoja	66,000	
- Zhvlerësimi i akumuluar në 1 janar 2023		33,000
Stoqet në 1 janar 2023		42,700
Paraja në bankë	4,100	
Llogaritë e arkëtueshme	48,400	
Llogaritë e pagueshme		18,900
Zbritja e marrë	5,200	
Zbritja e lejuar		2,400
Shitjet		220,000
Blerjet	141,000	
12% Obligacione		48,000
Interesi në hua		7,200
Shpenzimet e pagave	34,000	
Shpenzimet e qirasë	19,500	
Shpenzimet e rrymes	7,600	
Kthimet e blerjes	2,500	
Kthimet e shitjeve		2,200
Shpenzimet e shitjes dhe shpërndarjes	9,500	
Dividenta e paguar		3,000
Fitimi i mbajtur		<u>6,000</u>
	<u>421,800</u>	<u>461,400</u>

Informacione shtesë:

1. Drejtorët e Kamelia shpk propozuan të transferonin 15,000€ nga fitimet në rezervën e përgjithshme. Stoqet më 31 dhjetor 2023 ishin 35,000€.
2. Pagat me vlerë 8,500€ ishin të papaguara në fund të periudhës.
3. Qiraja ishte parapaguar me 3,900€ për tre (3) muajt e parë të vitit 2024.
4. Zhvlerësimi kalkulohet sipas metodes drejtëvizore për vitin si më poshtë:
 - o Mjetet motorike: 33%
 - o Mobilje dhe Pajisje: 10%

Kërkesa:

(a) Përgatitni bilancin vërtetues të korrigjuar më 31 dhjetor 2023.

(10 pikë)

b) Përgatitni Pasqyrën e të Ardhurave dhe shpenzimeve për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2023.
(10 pikë)

[Totali: 20 Pikë]

Zgjidhja e problemit 4

a) Kamelia shpk

Bilanci vërtetues i korigjuar më 31 dhjetor 2023		Debi	Kredi
		€	€
Kapitali i aksioneve të zakonshme			60,000
Rezerva e përgjithshme			30,000
Mjetet Motorike	- Kosotoja	54,000	
	- Zhvlerësimi i akumuluar me 1 janar 2023		18,000
Mobilje dhe Pajisje	- Kostoja	66,000	
	- Zhvlerësimi i akumuluar me 1 janar 2023		33,000
Stoqet me 1 janar 2023		42,700	
Paraja në bankë		4,100	
Llogaritë e arkëtueshme		48,400	
Llogaritë e pagueshme			18,900
Zbritja e marre			5,200
Zbritja e lejuar		2,400	
Shitjet			220,000
Blerjet		141,000	
12% Obligacione			48,000
Interesi në hua		7,200	
Shpenzimet e pagave		34,000	
Shpenzimet e qirasë		19,500	
Shpenzimet e rrymes		7,600	
Kthimi i blerjeve			2,500
Kthimi i shitjeve		2,200	
Shpenzimet e shpërndarjes dhe shitjes		9,500	
Dividenda e pagueshme		3,000	
Fitimi i mbajtur			6,000
		<u>441,600</u>	<u>441,600</u>

b) Kamelia shpk

Pasqyra e Te ardhurave dhe shpenzimeve per vitin qe perfundon më 31 dhjetor 2023

	€	€	€
Të hyrat (220,000- Kthimet e shitjeve 2,200)			217,800
KMSH:			
Stoqet në fillim		42,700	
Blerjet	141,000		
Kthimi i blerjeve	<u>(2,500)</u>		
		<u>138,500</u>	
		181,200	
Stoqet në fund		<u>(35,000)</u>	
			<u>(146,200)</u>
Fitimi bruto			71,600
Të ardhurat tjera – zbritja e marrë			<u>5,200</u>
			76,800
Shpenzimet:			
Shpenzimet e pagave (34,000+8,500)		42,500	
Shpenzimet administrative dhe të shitjes		9,5	
Shpenzimet e qirasë (19,500 – 3,900)		15,600	
Shpenzimet e rrymes		7,600	
Zbritja e lejuar		2,400	
Interesi në hua		7,200	
Zhvlerësimi: mjetet motorike (54,000 × 33 %)		18,000	
Mobilje dhe Pajisje (66,000 × 10%)		<u>6,600</u>	
			<u>(109,400)</u>
Humbja për vitin			<u>(32,600)</u>

Problemi 5

Draft pasqyrat e pozitës financiare të Saranda dhe filialit të saj Petriti më 31 tetor 2024 janë si vijon :

	<i>Saranda</i>		<i>Petriti</i>	
	€'000	€'000	€'000	€'000
<i>Pasuritë</i>				
<i>Pasuritë jo-qarkulluese</i>				
<i>Pasuritë e prekshme</i>				
Toka dhe Ndërtesat		315,000		278,000
Fabrika		<u>285,000</u>		<u>220,000</u>
		600,000		498,000
<i>Investimet</i>				
Aksionet në Petriti me kosto		660,000		-
<i>Pasuritë qarkulluese</i>				
Stoqet	357,000		252,000	
Llogaritë e arkëtueshme	525,000		126,000	
Paraja në bankë	<u>158,000</u>		<u>30,000</u>	
		<u>1,040,000</u>		<u>408,000</u>
		<u>2,300,000</u>		<u>906,000</u>
<i>Ekuiteti dhe detyrimet</i>				
<i>Ekuiteti</i>				
Aksione të zakonshme nga €1 secila		1,500,000		600,000
Fitimet e mbajtura		<u>580,000</u>		<u>212,000</u>
		2,080,000		812,000
<i>Detyrimet afatshkurtëra</i>				
Llogaritë e pagueshme		<u>220,000</u>		<u>94,000</u>
<i>Total ekuiteti dhe detyrimet</i>		<u>2,300,000</u>		<u>906,000</u>

Informacioni i mëposhtëm është gjithashtu në dispozicion.

- (a) Saranda ka blerë 480 milionë aksione të Petritit disa vite më parë, kur Petriti kishte fitime të mbajtura prej €95 milionë në rezerva. Vlera e drejtë e interesit jo kontrollues në datën e blerjes ishte €165 milionë.
- (b) Në datën e blerjes, toka e Petritit ishte rivlerësuar në €70 milionë më shumë se vlera në libra. Rivlerësimi nuk u regjistrua në llogaritë e Petritit.
- (c) Stoqet e Petritit përfshijnë mallrat e blera nga Saranda me çmim i cili përfshinë fitimin për Saranden prej €12 milionë.
- (d) Më 31 tetor 2024 Pertriti i ka borxh €25 milionë Sarandes për mallrat e blera gjatë vitit.

Kërkohet

- (a) Llogaritni në total zërin e mirë të shfaqur në konsolidim.
- (b) Përgatitni pasqyrën e pozitës financiare të konsoliduar të Sarandes me 31 tetor 2024.

(20 pikë)

Zgjidhja e problemit 5

(a) Kalkulimi i zërit të mirë

	€'000	€'000
Vlera e drejtë e konsideratës së transferuar		660,000
Plus vlera e drejtë e IJK-së në blerje		165,000
Minus vlera e drejtë neto në datën e blerjes e pasurive të identifikueshme të blera dhe detyrimeve të pranura:		
Kapitali aksionar	600,000	
Fitimet e mbajtura në blerje	95,000	
Korrigjimet e vlerës së drejtë të tokës	70,000	
		<u>(765,000)</u>
Zëri i mirë		60,000

(b) SARANDA GROUP
PASQYRA E POZITËS FINANCIARE E KONSOLIDUAR ME 31 TETOR 2024

	€'000	€'000
<i>Pasuritë</i>		
Pasuritë jo-qarkulluese		
Zëri i mirë		60,000
Toka dhe ndërtesat (315 + 278 + 70)		663,000
Fabrika (285 + 220)		<u>505,000</u>
		1,228,000
Pasuritë qarkulluese		
Stoqet (357 + 252 - 12)	597,000	
Ll.Arkëtueshme (525 + 126 - 25)	626,000	
Paraja në bankë (158 + 30)	<u>188,000</u>	
		<u>1,411,000</u>
		<u>2,639,000</u>

Ekuiteti dhe detyrimet

Ekuiteti që i takon mbajtësve të kompanisë mëmë

Aksione të zakonshme nga €1 secila 1,500,000

Fitimet e mbajtura(LL2) 661,600

Interesi jo kontrollues (LL3) 188,400

2,350,000

Detyrimet afatshkurtra

Ll.Pagueshme (220 + 94 - 25) 289,000

Total ekuiteti dhe detyrimet 2,639,000

Llogaritjet

1 *Struktura e grupit*

$$\frac{480\text{m}}{600\text{m}} = 80\%$$

2 *Fitimet e mbajtura*

Saranda Petriti

€m €m

Sipas pyetjes 580.0 212

Fitimi i pa-realizuar (12.0)

Fitimet e mbajtura para blerjes (95)

117

Pjesa e grupit e fitimeve të mbajtura pas blerjes

Grupit (80% × 117) 93.6

Fitimet e mbajtura të grupit 661.6

3 *Interesi i pa kontrollueshëm*

€m

Vlera e drejtë e IJK-së në datën e blerjes 165.0

Plus pjesa e IJK-së e fitimeve të mbajtura pas blerjes (20% × 117) 23.4

IJK në datën e raportimit 188.4